

FJALA E DEPUTETES OGERTA MANASTIRLIU

E ENJTE 7 KORRIK 2022

Të nderuar kolegë deputetë,

Të dashur qytetarë,

Ligji i ri “Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë” ka për qëllim që të sigurojë dhe të garantojë ofrimin e shërbimit spitalor, bazuar në standardet e cilësisë, sigurisë së ofrimit të shërbimit spitalor, duke synuar respektimin e të drejtës themelore për shërbime shëndetësore të aksesueshme dhe cilësore. Ky ligj është hartuar në frymën e parimeve të universalitetit, solidaritetit, mosdiskriminimit dhe standardeve të etikës mjekësore dhe deontologjisë, duke pasur pacientin në qendër të shërbimit shëndetësor. Ai është pjesë dhe çon përpara reformën në sistemin shëndetësor dhe, sigurisht, është hartuar duke pasur në vëmendje të gjitha zhvillimet në sektorin shëndetësor, përmirësimin e vazhdueshëm të shërbimeve spitalore, rritjen e financimit publik për shëndetësinë në këto vite, përmirësimin e infrastrukturës spitalore dhe pajisjeve biomjekësore, si dhe të gjithë kontekstin socioekonomik të vendit.

Puna për hartimin e këtij ligji të ri është realizuar nga një grup ekspertësh jo vetëm shqiptarë, por edhe të huaj; është një ligj që vjen i maturuar, i gërshetuar me qëllimet tona strategjike, gjithashtu edhe me Strategjinë Kombëtare të Shëndetësisë 2020-2030, si dhe mundëson krijimin e një mjedisi konkurrues brenda sistemit spitalor publik. Rritja e cilësisë dhe performancës së sistemit shëndetësor, si dhe ulja e shpenzimeve nga xhepi janë disa nga sfidat që adresohen në këtë projektligj për arritjen e mbulimit shëndetësor universal, si qëllim afatgjatë i politikave tona shëndetësore. Në hartimin e këtij projektligji janë kryer të gjitha konsultimet, në të gjitha hallkat e shërbimit shëndetësor publik, jopublik, të përfaqësive të shoqatave të pacientëve dhe të komunitetit të mjekëve dhe stafeve të spitaleve.

Po kështu, ashtu sikurse e përmenda, kemi pasur konsultimet dhe rekomandimet përkatëse të ekspertëve ndërkombëtarë. Ligji që kemi sjellë për miratim ridimensionon shërbimet e kujdesit spitalor dhe synon të garantojë për sistemin shëndetësor dhe atë spitalor, në veçanti, formë të

re të funksionimit dhe të organizimit të spitaleve publike, duke përfshirë këtu modelin e autonomisë spitalore, për të siguruar më shumë transparencë të shpenzimeve në spitale; do të mundësojë një sistem efikas kundër korrupsionit brenda sistemit shëndetësor dhe do t'i rrisë imunitetin sistemit, duke shtuar garancitë për një shërbim cilësor; do të ketë dhe do të sjellë një menaxhim efektiv të burimeve njerëzore, një administrim dhe përmirësim të shpenzimeve dhe burimeve financiare të spitaleve nëpërmjet kostifikimit të procedurave klinike; do të mundësojë investime në teknologji dhe inovacion nëpërmjet mundësive të reja që ai krijon për rritjen e të ardhurave dytësore, të krijuara nga spitalet; do të aplikojë shërbime klinike sipas standardeve më të larta në spitale të akredituara.

Çfarë sjell ligji për qytetarët, për pacientët? Më shumë shërbime mjekësore afër vendbanimit, me organizimin e ri në nivel rajonal, sipas tipave të ndryshme të spitaleve, që organizohen nëpërmjet këtij ligji të ri; qendra të specializuara të shërbimit spitalor mbi bazë rajoni dhe qarku; shërbime efektive në spitale ditore dhe në ato në nivel bashkie; stafe mjekësore të motivuara që shërbejnë për pacientët, mundësi për të pasur shërbime më të shpejta në korsi të preferenciale. Për personelin mjekësor, pa dyshim, do të sjellë kushte më të mira pune në shërbimin spitalor; mundësi për rritjen e pagesave dhe shpërblimeve mbi bazën e pagesës për performancë në spitale, pra shpërblime sipas meritës për mjekët; mundësi për aplikimin e praktikës dyfishe në spitalet publike dhe, sigurisht, mundësi për edukimin në vazhdim nga vetë të ardhurat që do të gjenerojnë spitalet.

Risite që sjell ky projektligj: E para, do të kemi planin kombëtar spitalor, të miratuar nga Komiteti për Planifikim Kombëtar Spitalor, bazuar në të dhënat demografike të sëmundshmërisë, zhvillimet socio-ekonomike, ku do të përcaktohen koeficientët për organizimin spitalor, ndarjen e shtretërve për numër banorësh, gjithashtu, shërbimet kyçe që duhet të ketë çdolloj strukture spitali, qoftë në nivel rajoni, qoftë në nivel qarku apo bashkie në shërbime specifike. Shërbimet specialistike në rang rajoni do të përcaktohen në planin kombëtar, duke mundësuar një organizim më efektiv spitalor dhe, mbi të gjitha, një menaxhim shumë më të mirë dhe efektiv të burimeve njerëzore dhe financiare. Në këtë ligj parashikohet ndarja e spitaleve publike sipas modeleve spitalore krejt të veçanta, duke sjellë një mënyrë të

re organizimi; parashikohet rikategorizimi i spitaleve, duke mirëpërcaktuar lloje të spitaleve, që në ligjin aktual, në atë që shfuqizojmë sot, nuk ekzistojnë, sikurse janë spitalet ditore apo spitalet në nivel rajoni.

Pra, do të bëhet e mundur që spitalet në nivel qarku të mund të menaxhojnë shërbimet, por edhe burimet njerëzore dhe financiare, në mënyrë që qytetarët t'i marrin shërbimet më afër vendbanimit në këtë organizim të ri spitalor. Për herë të parë futet koncepti i autonomisë spitalore, një tjetër risi e projektligjit. Autonomia, si pjesë integrale e menaxhimit të sistemit spitalor publik, garanton barazi, aksesueshmëri, cilësi, siguri në ofrimin e shërbimit shëndetësor në kohë për pacientin. Përmes autonomisë së përshkallëzuar synojmë të rrisim nivelin e shërbimit dhe nuk e kemi thjesht të shpikur si model, por është një model, të cilin duam ta zbatojmë, duke marrë dhe duke mësuar nga ata që tashmë e kanë zbatuar dhe prej vitesh e aplikojnë modelin e autonomisë spitalore në botë.

Ajo që është vënë re nga aplikimi i autonomisë spitalore, është që në spitalet publike listat e pritjes shkurtohen, mundësohet një performancë më e mirë spitalore, në funksion të shërbimeve ndaj pacientit dhe në vendet ku aplikohet autonomia spitalore, rritet konkurrenca dhe ulen rastet e fataliteteve, pikërisht në sajë të angazhimit të stafeve, motivimit të tyre dhe mbështetjes nëpërmjet mekanizmave të shpërblimeve në bazë të meritës. Autonomia spitalore parashikohet të jetë në 2 lloje formash: modeli i autonomisë menaxheriale, që garanton dhënien e autonomisë administrative, organizative dhe rregullatore të spitaleve, si dhe modeli i autonomisë financiare, që garanton transformimin e spitaleve publike në institucione që vetëfinancohen, financohen nga buxheti i shtetit për shërbimet e përcaktuara, gjithashtu vlerësohet që të ardhurat dytësore, të ardhurat nga veprimtaritë e tjera të spitaleve të mund të përdoren nëpërmjet akteve nënligjore.

Gjithashtu, ligji u jep mundësinë të gjitha spitaleve të administrohen dhe të menaxhohen nga struktura, të cilat synojnë të rrisin transparencën e menaxhimit të fondeve në spitale, qoftë për spitalet të cilat do të menaxhohen nga sistemi që aktualisht kemi, pra përpara se të shkojnë drejt autonomisë spitalore, qoftë për spitalet që do të përfitojnë kartën e autonomisë spitalore,

do të kemi organe drejtuese të spitaleve, borde drejtuese, ekip menaxhues dhe drejtuesin apo administratorin e përgjithshëm të spitalit.

Ato spitale që do të përfitojnë kartën e autonomisë spitalore do të kenë hapësira të veçanta në këtë ligj, gjithashtu, që të lidhin kontrata me palë të treta, me kompani private të sigurimeve, si dhe me spitalet jopublike për shërbime specifike mjekësore, do të mundet të bashkëpunojnë për kërkime shkencore me institucione ndërkombëtare dhe të huaja edhe për teste klinike me kompani farmaceutike vendase, bazuar në legjislacionin në fuqi; të kontraktojnë shërbime joshëndetësore me sektorin jopublik dhe, gjithashtu, të mundet të sigurojnë të ardhura nga aktiviteti mjekësor dhe jomjekësor, ose të ardhura të tjera për zhvillimin e infrastrukturës, teknologjisë dhe burimeve njerëzore.

Kostot e shërbimeve do të kenë një rregullim të posaçëm në këtë ligj, ku përfshihen kostot e trajtimit, diagnostikimit ambulator apo të shtrimit në spital. Projektligji parashikon për herë të parë mënyrën e përlllogaritjes së kostove të shërbimit, duke u bazuar në shpenzimet e bëra nga institucioni për të gjitha stadet e diagnostikimit, kujdesit dhe trajtimit të pacientit dhe çdolloj kostoje tjetër e nevojshme për ofrimin e shërbimit spitalor. Praktika e dyfishtë nënkupton se mjekëve në spitalet publike mund t'u jepet mundësia, sigurisht brenda një strukture dhe akteve ligjore në fuqi të rregulluar, për të ofruar jashtë regjimit të punës dhe pa cenuar shërbimin publik, për të ofruar shërbime të konsultave ambulatore për pacientë jashtë sistemit të referimit. Kjo është një risi tjetër e këtij projektligji, por edhe prezantimi i konceptit të shërbimeve të turizmit shëndetësor është përfshirë në këtë projektligj. Ku do të aplikohet autonomia spitalore?

Sigurisht, qëllimi i këtij projektligji është ridimensionimi i të gjithë sistemit dhe shërbimeve të kujdesit spitalor, por sigurisht, nëse duam që autonomia spitalore, si një model i ri, të mundet të aplikohet dhe të gjejë zbatim në të gjitha spitalet publike, duhet ta pilotojmë atë, ndaj Spitali Memorial në Fier do të jetë spitali ku do të fillojë pilotimi i autonomisë menaxheriale, duke i hapur rrugë shtrirjes së këtij modeli në spitalet tona. Nga ky ligj do të përfitojnë direkt më shumë shërbime cilësore dhe më shumë shërbime afër vendbanimit pacientët dhe qytetarët, të cilët marrin shërbime në spitalet tona, gjithashtu do të përfitojnë direkt nga përmirësimi i

eficencës dhe administrimit të spitaleve më shumë se 13 mijë mjekë, infermierë, teknikë, staf ndihmës dhe administrativ, që do t'u mundësohen standardet më të larta dhe performancë e rritur në spitalet, ku ato do të punojnë.

Sigurisht, ky është një ligj, i cili vjen me një vizion të ri, duke u mbështetur në atë objektiv madhor, që programi ynë qeverisës ka, duke u mbështetur në objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm dhe në strategjinë kombëtare 10- vjeçare të shëndetësisë. Është një ligj i kontekstualizuar, por, nga ana tjetër, hap rrugë të reja për përmirësimin e sistemit spitalor në vend dhe, mbi të gjitha, u garanton autonominë spitaleve tona, në mënyrë që menaxhimi në territor të jetë më i shpejtë, më efektiv dhe, sigurisht, ajo që synojmë ne është të kemi më shumë shërbime afër vendbanimit për qytetarët dhe të rritet cilësia e këtij shërbimi.

Nëpërmjet këtij ligji ne garantojmë që, me fillimin e pilotimit, por edhe shtrirjes së modeleve të reja të organizimit spitalor, do të kemi akoma më shumë zhvillim brenda sistemit spitalor, gjë që do të influencojë direkt në të gjithë sistemin tonë shëndetësor publik, i cili do të ketë mundësi jo vetëm të rrisë aksesin e popullatës në shërbime, por, nga ana tjetër, të kemi një përgjigje më të shpejtë drejt asaj që ne duam, drejt një përgjigjeje më të shpejtë të sistemit shëndetësor publik ndaj problematikave shëndetësore të popullatës, por edhe t'i vijmë në ndihmë sistemit të kujdesit parësor, nëpërmjet një përgjigjeje të kujdesit spitalor më të shpejtë, më efektive dhe më të drejtpërdrejtë për qytetarët.

Ndaj, besojmë që ky projektligj do të jetë një gur themeli drejt një zhvillimi tjetër të sistemit të spitaleve tona publike dhe jemi të bindur që brenda këtij projektligji, duke përfshirë gjithashtu edhe të gjithë sistemin spitalor jopublik, si komplementar në këtë ligj, do të mund të garantojmë më shumë shërbime dhe, mbi të gjitha, të garantojmë shërbime cilësore drejt një niveli të ri dhe të një standardi të ri të shërbimit spitalor në vend. Shumë faleminderit për vëmendjen!